



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA  
MINISTËR I SHTETIT  
PËR RININË DHE FËMIJËT**

Nr. 3097 prot. Datë 31.05 2024

**MINISTRIA E EKONOMISE,  
KULTURËS DHE  
INOVAIONIT**

Nr. 7213 prot. Datë 31.5 2024

Lënda : Përcillet informacioni mbi procesin e rishikimit të Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”,

**ZONJËS ZHENI GJERGJI  
KRYETARE E KOMISIONIT PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE  
SHËNDETËSINË  
KUVENDI I SHQIPËRISË**

*Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.4.*

E nderuar Kryetare,

Në vijim të njoftimeve të mbërritura nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, të Kuvendit të Shqipërisë për pjesëmarrjen e institucioneve tona në diskutimin projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45, datë 28.4.2016 “Për vullnetarizmin” të propozuar nga një deputet, lutemi gjeni për vëmendjen tuaj, një informacion të përmbledhur mbi hapat dhe procedurat e ndërmarra nga ana e Qeverisë Shqiptare për rishikimin e Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”.

Me konsideratë,

**MINISTËR**

**BORA MUZHAQI**



**MINISTËR**

**BLENDI GONXHJA**



## RELACION

### **Prezantim i hapave të ndërmarra në lidhje me procesin e rishikimit të Ligjit për Vullnetarizmin.**

(i)

Ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin”, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me iniciativë të një grupi deputetësh, duke ngritur kornizën ligjore për zhvillimin e vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë. Ligji në nenin 2 të tij parashikon se ky rregullim ka si qëllim rritjen e angazhimit qytetar dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor.

Pas miratimit të ligjit janë miratuar dhe aktet nënligjore: Vendimi i Këshilli i Ministrave Nr 506, date 17/07/2019 “Për miratimin e Kodit të Etikës së Vullnetarëve”; Urdhri i MFE-së Nr. 229/2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Kartës së Vullnetarit” dhe Urdhri i MFE NR 300/ 2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Regjistrimit të Kontratës së Vullnetarizmit”.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit janë: Ministria përgjegjëse për çështjet e punës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (pas ristrukturimit të shërbimit kombëtar të punësimit). AKPA ka detyrën të regjistrojë institucionet që janë të gatshëm të ofrojnë punë vullnetare, të lëshojë një numër reference dhe këto institucione mund të regjistrojnë më pas individë dhe t’i pajisin ata me librezë personale regjistrimi (Libreza e Vullnetarit ) dhe dokumentet përkatëse.

Vullnetarizmi perceptohet si një kontribut në dobi të qytetarëve dhe komunitetit që na rrethon. Në themel të vullnetarizmit ekziston gjithmonë nevoja e pakushtëzuar për të ndihmuar të tjerët. Ndonëse fasha moshore e vullnetarëve ka një spektrum të gjerë, në Shqipëri të rinjtë përbëjnë një ndër segmentet kryesore të personave që përfshihen në nisma qytetare vullnetare.

Organizatat që kanë më shumë se 60 vullnetarë janë kryesisht organizata që drejtohen nga të rinjtë dhe kanë në mision të punës së tyre realizimin e fushatave masive sensibilizuese, advokojnë për të mbrojtur të drejtat e të rinjve, grave apo fëmijëve (Partners Albania, 2019). Për këtë arsye edhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është angazhuar vullnetarizmi të nxitet dhe mbështetet në mënyrë të qëndrueshme për benefitet që ai jep për të rinjve nhkresë zhvillimin njerëzor, qytetar, shpirtëror dhe profesional të tyre.

Organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet e vullnetarëve në vend më gjithë vlerësimin e qëllimit të mirë të ligjit, kanë shprehur një numër shqetësimesh lidhur me efektet e ligjit, që kanë frenuar aktivitetin vullnetar në vend.<sup>1</sup>

Lidhur me problematikat në zbatimin e ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”, u mbajt më 21 shkurt 2022, një seancë dëgjimore në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, të Kuvendit të Shqipërisë, me deputetët dhe Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrinë e

<sup>1</sup> Studimi kombëtar Vullnetarizmi në Shqipëri, nga “Projekte Vullnetare Ndërkombëtare” në kuadër të projektit strategjik “Vullnetarizmi PikëAL”, mbështetur nga “LëvizAlbania”, projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Sdc. 2021. [https://beyondbarriers.org/wp-content/uploads/2021/10/Vullnetarizmi-ne-Shqiperi\\_-\\_Studimi-Kombetar\\_compressed.pdf](https://beyondbarriers.org/wp-content/uploads/2021/10/Vullnetarizmi-ne-Shqiperi_-_Studimi-Kombetar_compressed.pdf)

Letër e hapur e OSHC-ve drejtuar institucioneve shtetërore [https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/08/Mbi-Vullnetarizmin\\_AL-.pdf](https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/08/Mbi-Vullnetarizmin_AL-.pdf)

Financave dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ku u la rekomandim nga ky komision rishikimi i Ligjit me qëllim adresimin e problematikave që do të lehtësonin zbatimin e tij dhe ndërmarrjen e një fushate ndërgjegjësuere për promovimin e ligjit dhe instrumenteve të tij.

Pas zhvillimit të këtij takimi, një rrjet gjerë i organizatave të shoqërisë civile të angazhuara me nismat e vlerësimit strukturor të Ligjit dhe ndikimin e tij kontaktuan Ministrin e shtetit për Rininë dhe Fëmijët lidhur me nevojën për adresimin në mënyrë të plotë dhe efektive të gjitha problematikave strukturore dhe të zbatimit të evidentuar gjatë procesit të analizës së Ligjit 45/2016 “Për Vullnetarizmin”. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë përgjegjës për çështjet e punësimit dhe Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive zhvilluan më datë 29 mars 2022 një takim me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile ku përfshiheshin: Qendra Kombëtare Burimore e Shoqërisë Civile, Organizata Përtej Barrierave, World Vision, Korpusi i Vullnetarëve, Arka, Qendra Rinore Vlorë, Qendra Progres dhe Zhvillim. Gjatë këtij takimi, u diskutuan në detaje aspektet më problematike të Ligjit sipas vlerësimit të OSHC-ve ku u theksuan veçanërisht njohja e punës vullnetare, kontraktimin dhe regjistrimin e vullnetarëve, kostot e sigurimit të tyre, por edhe nevojën për të gjetur mënyrën për ta kthyer Ligjin në një instrument nxitës dhe mundësues për vullnetarizmin në Shqipëri. Nisur nga tërësia dhe shumëllojshmëria e elementëve që duhet të trajtohen dhe adresohen, si dhe me synimin për të përgatitur një produkt që i përgjigjet nevojave të sotme dhe të ardhshme të zhvillimit të vullnetarizmit në vend, përfaqësuesit e Qeverisë Shqiptare dhe OSHC-ve ishin në një mendje dhe ranë dakord që Ligji 45/2016 “Për Vullnetarizmin” ka nevojë të rishikohet në mënyrë tërësore dhe ky proces rishikimi duhet bërë bashkërisht me shoqërinë civile, duke përdorur të gjitha resurset e disponueshme dhe të dhënat e mbledhura përgjatë dy viteve të fundit.

Me date 16 maj 2022, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët njoftoi përmes emailit Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë mbi nevojën për të zhvilluar një dëgjese të dytë me deputetet e këtij komisioni, bashkërisht me organizatat e shoqërisë civile, lidhur me nevojën e rishikimit tërësor të Ligjit 45/2016 “Për Vullnetarizmin”. Një kërkesë e tillë u ripërsërit nga Ministrja Muzhaqi gjatë prezantimit të projekt buxhetit 2023 për rininë dhe fëmijët në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë të Kuvendit, por kërkesa mbeti pa përgjigje.

## (ii)

Këshilli i Ministrave ka parashikuar si iniciativë të vetë ligjvënëse hartimin dhe miratimin brenda katër-mujorit të III-të të vitit 2024 të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45, datë 28.4.2016 “Për vullnetarizmin”. Projektligji është përfshirë në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, referuar Vendimit nr. 790, datë 28.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në këshillin e ministrave gjatë vitit 2024” (lidhje: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/790>) dhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, referuar Vendimit nr. 16, datë 11.01.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026” (lidhje: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/01/11/16>). Të dy këto dokumente janë konsultuar dhe bashkërenduar me Kuvendin e Shqipërisë përpara miratimit të tyre.

Rishikimi i Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” është parashikuar si bashkëpropozim i Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe duhet të miratohet nga gjatë katër-mujorit të III-të të vitit 2024. Synimi i kësaj nisme është të rregullojë dhe

përmirësojë ligjin ekzistues 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe të krijojë kushtet për krijimin e një mjedisi nxitës dhe mundësues për vullnetarizmin në vend.

Objektivat konkrete që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji përfshinë:

- Rregullimin e paqartësive dhe problematikave të evidentuara në zbatim e ligjit;
- Përmirësimi i ligjit për të krijuar kushtet efektive për zhvillimin e vullnetarizmit në vend;
- Sigurimi i lidhjes me planin kombëtar për aderimin në BE-së. Harmonizimin e ligjit me parashikimet e Rekomandimit të Këshillit Europian të (2022/C 157/01) për Mobilitetin e Vullnetarëve të rinj në BE.

Përmes Urdhrit të Kryeministrit Nr 9, datë 17.1.2024 është ngritur Grupit Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”. Grupi Ndërinstitucional i Punës përfshin përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare të Rinisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve. Në mbledhjet e GNP-së janë ftuar të marrin pjesë dhe kontribuojnë edhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile të angazhuara vlerësimin strukturor të ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”, me qëllim përdorimin e të gjitha informacioneve dhe burimeve të disponueshme në kthimin e ligjit në një ligj efektiv dhe të qëndrueshëm, që do të përmirësojë strukturën e vullnetarizmit dhe krijojë një mjedis më mundësues për sektorin në Shqipëri.

Në varësi të shkallës së ndërhyrjes së nevojshme në Ligjin 45/2016 “Për vullnetarizmin”, Grupi Ndërinstitucional i Punës do të përcaktojë nëse do vijohet me rishikim pjesor të ligjit apo me një rishikim tërësor të tij dhe propozimit të një Ligji krejtësisht të ri.

Institucionet tona mbeten të gatshme të zhvillojnë një dëgjuesë të posaçme me kolegët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë apo Klubin Parlamentar për të Rinjtë për prezantimin e propozimeve ligjore për rishikimin e Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” sapo të jenë gati, me qëllim marrjen e mendimeve paraprake nga kolegët e Kuvendit të Shqipërisë parapara finalizimit të propozimeve në Këshillin e Ministrave.